

Fillimi > -Kronikë

Sherr dhe shkëmbim zjarri mes dy makinave, ç'ndodhi sot në Elbasan, arrestohet “korçari” brenda Spitalit të Traumës

25 Nëntor, 2020 16:41 | 5 293 shfletime



Madhësia e tekstit:  

 Policia e Elbasanit zbardh atentatin e ndodhur mesditën e sotme në këtë qytet, ku nga një atentat me armë zjarri mbeti i plagosur një person.

 Policia ka arrestuar njërin prej autorëve, shtetasin Elvis Koçi (Çaushllari), 28 vjeç, banues në Elbasan, teksa ka tentuar të mjekohej në spitalin ushtarak në Tiranë.

 Ndërkohë, sipas uniformave blu, sherri ka nisur mes drejtuesve të dy automjeteve, të cilët më pas kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të njëri-tjetrit.

28-vjeçari i arrestuar rezulton të jetë një person me rekorde kriminale, ndërsa njëhej dhe me nofkën “korçari”.

Njoftimi i policisë:

Zbardhet ngjarja e ndodhur mesditën e sotme në Elbasan.

Policia vë në pranga një nga autorët e ngjarjes.

Shpallet në kërkim autori tjetër.

Strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur rreth orës 11:50, në lagjen “Emin Matraxhiu”, Elbasan, ku gjatë një konflikti të çastit mes dy drejtues automjeteve ishin përdorur dhe armë zjarri, organizuan punën dhe falë veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale, bënë të mundur zbardhjen e ngjarjes.

Si rezultat i veprimeve u bë identifikimi, lokalizimi dhe arrestimi i njërit prej autorëve, shtetasi Elvis Koçi (Çaushllari), 28 vjeç, banues në Elbasan.

Si dhe u bë shpallja në kërkim e autorit tjetër të kësaj ngjarjeje, shtetasi Migert Qosja, 25 vjeç, banues në Elbasan.

Nga veprimet e para hetimore rezulton se Elvisi, duke drejtuar automjetin tip “Mazda”, është konfliktuar fizikisht me Migertin, i cili drejtonte automjetin tip “Ford” dhe më pas të dy palët kanë qëlluar në drejtim të njëri-tjetrit me armë zjarri. Si pasojë shtetasi Elvis Koçi është plagosur lehtë dhe për t’i shpëtuar Policisë, ka tentuar të mjekohej në spitalin ushtarak në Tiranë, por është arrestuar në flagrancë.

Nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes, identifikimin, kapjen dhe arrestimin e personave të tjerë të implikuar në këtë ngjarje.

Vijojnë kontrollet intensive nga Policia e Elbasanit, për kapjen e autorit të dytë të kësaj ngjarjeje, shtetasi Migert Qosja.


Materialet hetimore në ngarkim të dy shtetasve i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtja pa leje”.

(BalkanWeb)

Për t’u bërë pjesë e grupit “Balkanweb” mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [atentati](#) [Elbasan](#) [elvis caushllari](#) [elvis koci](#)

TË NGJASHME


 “I zunë pritë dhe qëlluan me armë”, flet vëllai i autorit të atentatit në Bulqizë: Ja si ndodhi ngjarja, kushërinjtë e nisën të parët, zanafilla e konfliktit 21 Nëntor, 2020	 Ekskluzive/ “Na kanë shpallur luftë si fis”! Flet njëri prej kushërinjve që i shpëtoi atentatit në Bulqizë: Djalit i vunë armën në kokë, mua më rrahën... 20 Nëntor, 2020
---	--

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

 VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë... 30 Nëntor, 2020	 Aksidenti me një të vdekur në Golem, policia: Në motor edhe një pasagjere, u dërgua në spitalin e Durrësit 30 Nëntor, 2020
Aksident i rëndë në Golem, furgoni përplasat me motorin në autostradë, ndërron jetë drejtuesi (EMRI) 30 Nëntor, 2020	Aksident në Ersekë/ Plagoset rëndë një person, dërgohet me urgjencë në spital 30 Nëntor, 2020
“Nuk kemi asnjë përgjigje nga analizat”, flet vëllai i pacientit që u hodh nga Covid2: I thash ‘mos shko në spital’, motrës i rrëfeu se ... 30 Nëntor, 2020	I infektuar me Covid-19, vlonjati tenton të kalojë Kakavijë, gjobitet me 700 mijë lekë 30 Nëntor, 2020

KATEGORIA VIDEO

 VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë... 30 Nëntor, 2020	 Kur Haga shpallte të pastër luftën e UÇK-së 18 vite më parë/ Lirimi i Fatmir Limaj dhe pritja madhështore në Kosovë 30 Nëntor, 2020
Këngë nga e gjithë bota, çifti Janaqi propozojnë menunë me 2000 këngë për ndjekësit 30 Nëntor, 2020	“Tentuan të më digjinin të gjallë, gjeta dy shishe benzinë” / 52-vjeçarja rrëfen divorcin: Ndihehem kërcënuar, kërkoj ndihmën e shtetit 30 Nëntor, 2020
“Gënjeshtra i shkon për shtat”, Jorida Tabaku: Ja si Rama po i bën rrush e kumbulla taksat e shqiptarëve 29 Nëntor, 2020	Aksident në Berat/Fuoristrada del nga rruga, për pak sa nuk përfundon në lumë. Shpëton mrekullisht shoferi (VIDEO) 29 Nëntor, 2020

FAQET ZYRTARE

News24
Gazeta Shqiptare
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISE

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Emisioni Chic
Emisioni Diplomaticus
Emisioni Vila 24
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Monitor Ekonomi
Real Story
Shqiptarët për shqiptarët
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

